



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2916 Prot.

Lezhë, më 04 . 03 . 2024

**VENDIM**

**Nr. 22, Datë 29. 02. 2024**

**PËR**

**MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË BASHKISË LEZHË PËR VITIN 2023**

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”; dhe të Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

**Vendosi:**

1. Miratimin e Buxhetit Faktik të Bashkisë Lezhë për vitin 2023, sipas raportit dhe pasqyrave përkatëse, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI  
NDUE LULI**

